



PRODHO DHE VISHU SHQIP

KONFERENCA E PARË KOMBËTARE

E ARDHMJA E INDUSTRISË FASON NË SHQIPËRI

Qendra e Inovacionit të Biznesit për Industrinë
Tekstile dhe të Veshjeve dhe Zona Industriale Pilot e
Investimeve si promotorë të rritjes



Tex-WeB



Konferenca: "E ardhmja e Industrisë Fason në Shqipëri: Qendra e Inovacionit të Biznesit për Industrinë Eksportuese të Tekstileve dhe të Veshjeve dhe Zona Industriale Pilot e Investimeve si promotore të rritjes", zhvillon punimet me date 16 Dhjetor 2011 e organizuar nga Dhoma e Fasonistëve të Shqipërisë, me mbështetjen e Euratex dhe TexWeb dhe në partneritet me: USAID, GIZ, Cooperazione Italiana, Agjencinë Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve (AIDA), Ministrinë e Ekonomisë, Transporteve dhe Energjetikës dhe Universitetin Politeknik të Tiranës.

Kjo konferencë synon të rrisë vizibilitetin e industrisë tekstile në Shqipëri për rëndësinë që paraqet kjo industri për zhvillimin ekonomik të vendit tonë dhe në të njëjtën kohë synon që të ulë në një diskutim të përbashkët, konstruktiv e konkret, të gjithë aktorët dhe palët e interesuara për zhvillimin e kësaj industrie, duke i dhënë mundësinë e zhvillimit dhe promovimit të kësaj industrie në Shqipëri, rajon, Europë e më gjerë, për thithjen e investitorëve potencialë. Në të njëjtën kohë aktivitetet e Dhomës së Fasonistëve brenda dhe jashtë Shqipërisë, në partneritet të plotë me Konfederatën e Industrisë Tekstile Europiane (EURATEX), por edhe me mbështetjen e partnerëve lokal, po bëjnë që kjo industri të ecë në drejtimin e duhur, të zhvillohet e të përmirësohet me konceptet zhvilluese bashkëkohore europiane, por të shërbejë gjithashtu edhe si promotore e inovacioneve në industrinë shqiptare të tekstileve.

Gjithashtu kjo Konferencë do të hedhë për diskutim disa nga kërkesat aktuale të biznesit Fason në Shqipëri, sic janë: cila është e ardhmja e kësaj industrie në Shqipëri, krijimi i një zone industriale pilot (biznes-parku) të investimeve në Tiranë, krijimi i një qëndre të inovacionit të biznesit të industrisë së tekstileve e veshjeve, si dhe incentivat e domosdoshme që ka nevojë ky sektor në këtë moment të rritjes cilësore të tij, si sektori me impaktin më të madh në punësim e në eksportet shqiptare.

Në këtë Konferencë janë të ftuar e do të marrin pjesë: Kryeministri i Shqipërisë Shkëlqesia e Tij z. Sali BERISHA referuar rëndësisë që ka ky sektor për rritjen e ekonomisë së vendit dhe prioritetit të qeverisë për mbështetjen e sektorit Fason, Ministri i Ekonomisë z. Nasip NACO, investitorë dhe biznesmenë të spikatur të sektorit të industrisë vendase, Rajonale e Europiane, përfaqësues nga Delegacioni i Bashkimit European në Shqipëri, përfaqësues nga USAID, përfaqësues nga GIZ, Cooperazione Italiana, e të tjerë, si dhe përfaqësues të biznesit nga Kosova dhe Maqedonia duke synuar që kjo konferencë e parë për industrinë tekstile të jetë panshqiptare.

Duke ju falenderuar për mbështetjen dhe angazhimin Tuaj,

Për Dhomën e Fasonistëve të Shqipërisë

Kryetari, Gjergji GJKA

Axhenda e Konferencës

E Premte, 16 Dhjetor 2011 – Tirana International Hotel

10:00 – 10:10	Fjala e Mirëseardhjes për të pranishmit nga Dhoma e Fasonistëve të Shqipërisë Z. Ilirjan Zhilla, Moderator i Konferencës Kombëtare & Kryetar i Unionit të Dhomave të Tregtisë e të Industrisë të Shqipërisë
10:10 – 10:30	Fjala Përshendetëse nga Qeveria Shqiptare Sh.T. Z. Sali Berisha, Kryeministër i Shqipërisë
10:30 – 10:50	E ardhmja e Industrise Fason në Shqipëri: Qendra e Inovacionit të Biznesit për Industrinë Tekstile dhe të Veshjeve dhe Zona Industriale Pilot e Investimeve si promotorë të rritjes Z. Gjergji Gjika, Kryetar i CFA
10:50 – 11:10	Perspektivat e ardhshme të Industrisë Tekstile dhe të Veshjeve në Europë (paneumed) dhe roli i mundshëm për Industrinë Tekstile dhe të Veshjeve për Shqipërinë Z. Francesco Marchi, Drejtor Ekzekutiv i Euratex
11:10 – 11:25	Programet e Bashkimit European për të mbështetur Inovacionin e Biznesit Shqiptar në Industrinë Tekstileve dhe të Veshjeve: Rezultatet dhe perspektivat për Industrinë Shqiptare të Veshjeve Z. Clive Rumbold, Shef i Seksionit të Politikës së Delegacionit të EU në Shqipëri
11:25 – 11:30	Zj. Oriana Mazzali, Projekti Tex – Web, Programi EU-IPA
11:30 – 12:00	Pushim kafe
12:00 – 12:20	Fondet dhe Politikat e Investimeve të Agjencisë Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (A.I.D.A) për Industrinë Shqiptare Fason dhe për Industrinë Tekstile dhe të Veshjeve Zj. Eneida Guria, Drejtoreshë Ekzekutive e A.I.D.A
12:20 – 12:45	Kontributi dhe mbështetja e USAID për Industrinë e Tekstileve dhe të Veshjeve dhe projektet për të ardhmen për këtë sektor Z. Victor Luboyeski, Drejtor i Projektit Rritje Albania të USAID
12:45 – 13:00	Histori Sukses: USAID – Universiteti Politeknik i Tiranës, Departmenti i Tekstitit & Modës Z. Genti Guxho, Zv. Dekan
12:45 – 13:00	Kontributi dhe Mbështetja e GIZ për Industrinë e Tekstileve dhe të Veshjeve dhe projektet për të ardhmen për këtë sektor Z. Helmut Mueller-Glodde, Programi i Zhvillimit Ekonomik dhe Promovimit të Punësimit G.I.Z
13:00 – 13:15	Mundësite reale të Kompanive Shqiptare për Tregje të reja në Itali: Perspektivat e Industrisë Shqiptare të Tekstileve dhe të Veshjeve në tregun italian të veshjeve Dott. Martino Salino, Platforma Italo-Shqiptare e Industrisë Tekstile
13:15 – 13:30	Tregjet e reja per Industrinë Shqiptare të Veshjeve: Perspektivat e Industrisë Shqiptare të Tekstileve dhe të Veshjeve në tregun gjerman të veshjeve Z. Wolfgang Weis, Weis Consulting Assoc.
13:30 – 14:00	Diskutimet dhe konkluzionet nga moderatori
14:00 – 14:30	Drekë Buffet

**WE HAVE A NEW ALBANIA,
YOU HAVE A NEW OPPORTUNITY!**

Chamber of Façon of Albania (C.F.A)
Your professional partner in Albania!

Useful contacts:
Rruga Sami Frashëri
Pallati 15, Shkalla 2, Apt. 12
1019 – Tirana, Albania

Mr. Gjergji GJIKA
Chairman

Tel & Fax: + 355 4 2 238 084
Mobile: + 355 (0) 69 40 33 228
E-mail: gjergji.gjika@yahoo.com
Web-Site: www.albania-textile.com

Mr. Ermir KASMI
Projects Manager

Tel & Fax: + 355 4 2 238 084
Mobile: +355 (0) 69 20 50 868
E-mail: ermirkasmi@gmail.com
Web-Site: www.albania-textile.com